



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:214912

Datë: 06.04.2021

Numri i dokumentit: 01665897

P.nr.1024/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtaren e vetme gjykuese Mimoza Shabani, me asistimin e praktikantës Kaltrina Namani në cilësinë e procesmbajtëses, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.E nga Ferizaj, për shkak të veprës penale në vazhdim vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm e evidentuar me numër: PP.II.nr.430-5/19 e datës 18 Shtator 2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, në praninë e përfaqësuesit të akuzës - prokurorit të shtetit Ajtene Zoni, përfaqësuesit të palës së dëmtuar Kompanisë KEDS Besart Selmani si dhe të akuzuarit me avokat mbrojtës (me autorizimi) Av.Elvira Heta-Vata, me datë 24 Mars 2021 mori dhe publikisht komunikoi, ndërsa me datë 06 Prill 2021, përpiloi me shkrim këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari:

N.Ei lindur me datë... nga i ati S. e ëma H. e gjinisë B., me vendbanim në Ferizaj, me profesion ndërtimtar-biznes afarist, i martuar baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal....

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 06.07.2018 e deri me datë 25.01.2019, në Ferizaj, gjatë kontrollit për verifikimin e kyçjeve të paligjshme në rrjetin elektrik nga ana e punëtorëve të SH.A. “KEDS” në Ferizaj, është konstatuar se i akuzuari është kyçur pa autorizim- pëlqim të funirnizuesit të autorizuar në rrjetin elektrik në ndërtesën-objektin banesor të tij, në atë mënyrë që e ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë ilegale, me ç’rast i ka shkaktuar dëm kompanisë “KEDS” në Ferizaj.

- **me të cilin veprim në vazhdim ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-ës.**

Andaj, Gjykata në bazë dispozitës së lartë shënuar si dhe neneve 2,4,7,8,17,38,39,40,43,,69,70 dhe 71 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 370 dhe 453 të KPP-ës, të akuzuarin e,

G J Y K O N

Dënim me gjobë në shumë prej 600 € /gjashtëqind euro/, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 ditëve, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 43 par. 3 të KPRK-ës, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, ku do të ekzekutohet në atë mënyrë që për çdo 20 € /njëzetë euro/ të gjobës së pa paguar, do ti llogaritet me 1/një/ ditë burgimi.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar Kompanisë KEDS-Distrikti Ferizaj për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € /njëzetë /euro, si dhe në bazë të nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 €uro /tridhjetë/, të gjitha brenda afatit prej 30 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ose do të bëhet përmbarimi i detyruar sipas detyrës zyrtare.

A r s y e t i m i

Historiku i procedurës

Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm Penal, me gjyqtaren e vetme gjykuese në çështjen penale kundër të akuzuarit N.E nga Ferizaj, për shkak të veprës penale në vazhdimësi vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.430-5/19 e datës 18 Shtator 2019.

Më datë 01 Shtator 2020, gjyqtarja e vetme e gjykuese ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor fillestar, dhe pas leximit të aktit akuzues, gjyqtarja u bind se i akuzuari e ka kuptuar akuzën, në bazë të nenit 246 par. 4 të KPRK-ës si dhe pas njoftimit sipas dispozitave të neneve 325 dhe 323 të KPPK-së, të akuzuarit i ofroj mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm, në të cilin i akuzuari është deklaruar i pafajshëm. Më datë 29 Shtator 2020, në gjykatë i akuzuari me avokat mbrojtës ka paraqitur kërkesë për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin të provave. Më datë 01 Tetor 2020 me aktvendimin P.nr.1024/19, është refuzuar kërkesa për hudhjen e aktakuzës si dhe kundërshtimi i provave si e pabazuar.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, duke vepruar sipas kësaj çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datë 24 Mars 2021 dhe pas njoftimit sipas dispozitave të neneve 325 dhe 323 të KPPK-ës dhe konsultimeve të mjaftueshme me avokaten mbrojtëse, të njëjtit i ofroj mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm, ku i akuzuari ka theksuar se e ndien veten fajtor dhe e pranon fajësinë sipas të gjitha pikave të aktakuzës, pranimin e ka bërë në mënyrë vullnetare duke qenë i vetëdijshëm për pasojat që mund të vijnë si rezultat i pranimin të fajësisë si dhe kërkon nga gjykata që ti shqiptoj një dënim më të butë.

Vlerësimi i pranimin të fajësisë dhe provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Pasi i akuzuari ka pranuar fajësinë në fillim të shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues vlerësoi se pranimi i fajësisë është në bazë të nenit 326 par.1 të KPP-së, se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, dhe mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga prokurori i shtetit përkatësisht: procesverbali me nr. 2233786 i dt, 21.07.2018, procesverbali me nr. 2507653 i dt, 24.07.2018, procesverbali me nr.2230339 i dt.08.08.2018, procesverbali

me nr. 2233754 i dt.24.08.2018, procesverbali me nr. 2233759 i dt.29.08.2018, procesverbali me nr.2230347 i dt.26.09.2018, procesverbali me nr.2230284 i dt.17.10.2018, procesverbali me nr.2233814 i dt.05.11.2018, procesverbali me nr. 2233737 i dt.07.11.2018, procesverbali me nr.2233804 i dt.21.11.2018, procesverbali me nr.2233809 i dt.23.11.2018, procesverbali me nr.2233817 i dt.07.12.2018, procesverbali me nr. 2233823 i dt.12.12.2018, procesverbali me nr.2234178 i dt.14.12.2018, procesverbali me nr.2234186 i dt.19.12.2018, procesverbali me nr.2233794 i dt.21.12.2018, procesverbali me nr.2226470 i dt.18.01.2019 si dhe procesverbali me nr.2234193 i dt.25.01.2019, foto dokumentacioni si dhe shkresat e tjera në lëndë.

Fjala përfundimtare e palëve

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 326 par.1 të KPPK-së, andaj gjyqtarja në bazë të nenit 326 paragrafit 3 të KPPK-së, ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve, ku prokurori i shtetit para paraqitjes së fjalës përfundimtare ka bërë ricilësimin e veprës penale në vjedhja e shërbimeve në vazhdim nga neni 314 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-ës, ka deklaruar se qëndron pranë aktakuzës së ngritur meqenëse ekziston dyshimi i bazuar mirë se i akuzuari ka kryer këtë vepër penale, ndërsa sa i për ketë pranim të fajësisë ka deklaruar se nuk e kundërshton meqë një pranim i tillë është bërë në bazë të dispozitave ligjore nga neni 248 lidhur me nenin 326 të KPPK-së, pra në mënyrë vullnetare nga i cili pranim ka mbështetje në të gjitha provat dhe shkresat që përmban aktakuza, andaj ka kërkuar që i njëjti të shpallet fajtor për veprën penale që akuzohet.

Përfaqësuesi i te dëmtuarës KEDS-Ferizaj në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet ne tërësi fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit, duke shtuar se ka prova të mjaftueshme që të akuzuarin t'a gjej dhe t'a shpallë fajtor, sa i përketë ndërhyrjeve të paautorizuara në rrjetin elektro - energjetik, duke pasur parasysh udhëzimet konkrete se si duhet bërë kycja në rrjet, sa i përketë kërkesën pasurore-juridike ka deklaruar se në këtë fazë të procedurës nuk mund ta bëjnë precizimin konkret të vlerës së dëmit, duke pasur parasysh se i akuzuari në kycjet ilegale ka pasur ngarkesa të tepërta në rrjetin elektrik në atë pjesë të rrugës dhe ndërprerjet e tepërta të rrymës.

Avokati mbrojtës i të akuzuarit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i mbrojturi i tij pranimin e ka bërë në mënyrë krejtësisht vullnetare dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mua si mbrojtës lidhur me pasojat dhe benifitet e këtij pranimi i cili në mënyrë të sinqertë edhe

në seancën fillestare ka deklaruar se kyçjet i ka bërë në orën e shtëpisë se vjetër, pra orë e shtëpisë se tij e cila i ka njehsuar të gjitha shpenzimet e rrymës për të cilat është ngarkuar me fatura dhe këto fatura i ka paguar, duke kërkuar nga gjykata që këtë pranim t'a marrë si rrethanë veçanërisht lehtësuese me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit. Gjithashtu ka kërkuar nga gjykata që me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit të aplikoj dispozitat nga neni 70 dhe 71 për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit nën minimumin e paraparë ligjorë, meqenëse në rastin konkret kemi të bëjmë me një njeri të respektueshëm në rrethin ku jeton, nuk është kryerës i veprave penale, pra nuk ka të kaluar kriminale, është udhëheqës i një biznesi kredibil, prandaj të gjitha këto rrethana të merren parasysh në momentin e matjes së dënimit, duke i propozuar gjykatës shqiptimin e dënimit me gjobë.

I akuzuari në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të avokatës së tij mbrojtëse dhe më shumë nuk ka se çfarë të shtoj, vetëm ka kërkuar nga gjykata që të i shqiptoj dënim sa më të butë duke marrë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e tij.

Gjykata po ashtu vërtetoi se prokurori ka disponuar me prova të mjaftueshme për veprën penale të akuzuarit dhe ka dhënë mendimin për pranimin e fajësisë nga ana e tij.

Por, gjykata vlerëson se në rastin objekt gjykimi, provohet përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari, ka kryer veprën penale në vazhdim vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, pasi që u vërtetua përtej çdo dyshimi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të kësaj veprë penale meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësisht në dispozitivat e këtij aktgjykimi, gjatë kontrollit për verifikimin e kyçjeve të paligjshme në rrjetin elektrik nga ana e punëtorëve të SH.A. "KEDS" në Ferizaj, është konstatuar se i akuzuari është kyçur pa autorizim- pëlqim të funirizuesit të autorizuar në rrjetin elektrik në ndërtesën-objektin banesor të tij, në atë mënyrë që e ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë ilegale, me ç'rast i ka shkaktuar dëm kompanisë "KEDS" në Ferizaj, andaj nga të lartë cekurat i akuzuari është përgjegjës për këtë veprë penale dhe i është shqiptuar dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtari konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Caktimi i dënimit për të akuzuarin

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 dhe 71 të KPRK-ës, si rrethanë lehtësuese vlerësoi pranimin e fajësisë për veprën penale të kryer, e cila është bërë në seancën e shqyrtimit gjyqësor, pendimin e tij për këtë veprë penale, kërkim falje, i pa dënuar më parë për vepra të ngjashme apo të tjera penale, e sa i përketë rrethanave veçanërisht rënduese gjyqtarja e vetme gjykuese vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit se kryesi veprën e ka kryer me dashje si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, ndërsa me rastin e vlerësimi të rrethanave rënduese gjykata nuk gjeti në rastin konkretë.

Mbi bazën e këtyre rrethanave, gjyqtarja e vetme gjykuese është e bindur se dënimi i shqiptuar është në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të akuzuarit, rrethanat dhe mënyrën e kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit, duke vlerësuar se edhe me dënim kryesor – dënim me gjobe do të arrihet qëllimi i dënimit kështu që me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv dhe me ekzekutimin tij do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPRK-ës, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë veprës penale dhe kryerjes, që do të shërbejë në parandalimin të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Kërkesa pasurore juridike si dhe shpenzimet procedurale

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPP-së, pasi që nga të dhënat e mbledhura gjatë zhvillimit të procedurës nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërisht si dhe e njëjta kërkesë nuk ka mundur të precizohet nga pala e dëmtuar deri në fjalën përfundimtare të saj.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës gjyqësore është marr në kuptim të dispozitës së nenit 453 par. 1 të KPPRK-së, ndërsa për kompensimin e viktimave të krimit është marrë në bazë të nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal

P.nr.1024/19 e datës 06 Prill 2021

Praktikante,

Kaltrina Namani

Gjyqtarja,

Mimoza SHABANI

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e parë e ardhshme pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj, për Gjykatën e Apelit të Kosovës.